

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Beton”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

44114000-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

2 040 000(dy milion e dyzet mijë) lekë pa tvsh, për procedurën me objekt prokurimi: “Blerje beton”.

Bazuar në nenin 76 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik” e ndryshuar, në zbatim të urdhërit të titullarit, për ngritjen e komisionit për përlogaritjen e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e vlerës limit të kontratës për procedurën e prokurimit, komisioni pasi u njoh me objektin e prokurimit, bazuar në VKM 285 datë 19.05.2021 neni 76, ka bere llogaritjen.

Çmimi për njësi është marrë nga Sistemi i Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim (Portali SIM), i administruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoritet kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteet e fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetare, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.”

Sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës Procedurë e hapur të thjeshtuar, edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj

procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.2.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin e fundit (duke përfshirë edhe kështet e maturuara për vitin 2026, duke pasur në vëmendje parashikimet e ligjit 9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetqeverisjes vendore), për të gjitha pikat e ushtrimit të veprimtarisë sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, nën 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kështeve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3 Kapaciteti Teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për furnizime të mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për furnizime të mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nën 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori ku merr përsipër në çdo kohë furnizimin e Autoritetit Kontraktor në vendin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar mbi disponibilitetin dhe korrektësinë e Operatorëve pjesëmarrës përgjate ekzekutimit të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori ku merr përsipër furnizimin sipas specifikimeve teknike të parashikuara në shtojcën 6 të DST.

Shenim: *Ne çdo rast Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të mallit përmbush specifikimet teknike.*

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.*

Me anë të së cilës ky i fundit deklaron se përmbushin plotësisht të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6.

Kjo kërkesë vendoset për të garantuar që operatori ekonomik merr përgjegjësi të plotë për përputhshmërinë e pajisjeve të ofertuara me kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktor, duke shmangur paraqitjen e ofertave që nuk plotësojnë parametrat e kërkuar. Deklarata shërben si një angazhim formal i ofertuesit, mbi bazën e të cilit Autoriteti Kontraktor verifikon dokumentacionin teknik dhe, në momentin e dorëzimit, konstaton përputhshmërinë me specifikimet teknike.

Kërkesa është në përputhje me parimet e proporcionalitetit, transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, pasi nuk kufizon konkurrencën dhe nuk favorizon një prodhues apo markë të caktuar, por synon vetëm të garantojë përmbushjen e kërkesave teknike të kontratës.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë pajisjet teknike/mjetet, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera

- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm);*
- *Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për mjetin e deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e*

nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se „5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit“.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike/mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit.

SPECIFIKIME TEKNIKE

Karakteristikat teknike

Betoni C-16/20 (me çakëll) duhet të plotësojë këto kërkesa:

- Të jetë beton i freskët, i përgatitur në impiant dhe i gatshëm për përdorim.
- Klasa e rezistencës në shtypje duhet të jetë C-16/20.
- Rezistenca karakteristike në shtypje, në moshën 28-ditore, duhet të jetë:
 - jo më pak se 16 N/mm² për provën cilindrike;
 - jo më pak se 20 N/mm² për provën kubike.
- Betoni duhet të përbëhet nga çimento, ujë, rërë, çakëll dhe, kur është e nevojshme, aditivë të përshtatshëm.
- Çimentoja duhet të jetë e përshtatshme për prodhimin e betonit të klasës së kërkuar dhe pa shenja lagështie apo ngurtësimi.
- Rëra dhe çakëlli duhet të jenë të pastër, të qëndrueshëm dhe me granulometri të përshtatshme.
- Agregatet nuk duhet të përmbajnë argjilë, dhera, materiale organike, kripëra ose papastërti të tjera që mund të ndikojnë në rezistencën dhe qëndrueshmërinë e betonit.

- Uji i përdorur në përzierje duhet të jetë i pastër dhe pa përbërës që ndikojnë negativisht në procesin e lidhjes dhe ngurtësimit.
- Përzierja duhet të jetë homogjene, pa grumbullime, segregim ose ndarje të dukshme të përbërësve.
- Konsistenca e betonit duhet të jetë e përshtatshme për transportimin, hedhjen, përhapjen dhe ngjeshjen e tij.
- Betoni duhet të ruajë punueshmërinë dhe karakteristikat teknike deri në momentin e dorëzimit dhe përdorimit.
- Nuk lejohet shtimi i pakontrolluar i ujit pas përfundimit të procesit të prodhimit, kur ky veprim ndryshon raportin e përzierjes ose ul rezistencën e kërkuar.
- Betoni nuk duhet të paraqesë shenja ngurtësimi të parakohshëm, tharjeje, mpiksjeje ose humbjeje të homogjenitetit.
- Transporti duhet të kryhet me autobetonierë ose me mjete të tjera teknologjiksht të përshtatshme, të cilat ruajnë homogjenitetin dhe cilësinë e betonit gjatë transportit.
- Betoni duhet të jetë i përshtatshëm për ndërhyrje rehabilituese, betonimin dhe sistemimin e segmenteve rrugore, trotuareve, shesheve dhe sipërfaqeve të tjera publike.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, pjesë e DST.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e mallit dhe lidhen ngushtë me natyrën e kontratës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo specifikim dhe standard të kërkuar.

Specifikimet e mësipërme nuk kufizojnë konkurrencën dhe nuk favorizojnë asnjë markë, prodhues apo operator ekonomik të veçantë, pasi janë bazuar në standarde të njohura të tregut dhe shoqërohen me termin "ose ekuivalent" kur është e nevojshme.

Ato përfaqësojnë kërkesat minimale teknike që duhet të plotësojë produkti për të garantuar funksionalitetin, cilësinë dhe qëndrueshmërinë e mallit.

NJESIA E PROKURIMIT